



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**Kuvendi**

**PROJEKTLIGJ**

Nr. \_\_\_\_\_/2026

**"PËR**

**KRIJIMIN DHE FUNKSIONIMIN E SHOQËRISË SHTETËRORE TË PYJEVE"**

Bazuar në nenin 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**  
**Objekti**

Ky ligj ka për objekt krijimin, organizimin dhe funksionimin e shoqërisë shtetërore përgjegjëse për administrimin, zhvillimin dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të pasurisë pyjore shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

**Neni 2**  
**Krijimi i shoqërisë**

1. Shoqëria Shtetërore e Pyjeve sh.a., me emrin e shkurtuar "SHSHP.sh.a" është shoqëri aksionare me kapital 100% shtetëror, e themeluar me qëllim menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor në Shqipëri.
2. Autoriteti publik, që përfaqëson shtetin si pronar të 100% të aksioneve të shoqërisë aksionare, është ministria përgjegjëse për pyjet.
3. Kapitali fillestar për krijimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a., është 50,000.000 (pesëdhjetë milion) lekë.

**Neni 3**

- ii. tregtimi i bimëve medicinale dhe eterovajore;
- iii. kreditet e karbonit;
- e) monitorimin dhe inventarizimin e burimeve pyjore;
- ë) bashkëpunimin me sektorin public, qëndror dhe vendor, sektorin privat dhe partnerët ndërkombëtarë.

#### **Neni 8** **Transferimi i asetëve**

1. Pasuria pyjore shtetërore transferohet në administrim të SHSHP sh.a., pa ndryshuar pronësinë publike.
2. Transferimi kryhet me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas një plani të detajuar inventarizimi.
3. Njësitë e qeverisjes vendore vazhdojnë të ushtrojnë kompetencat e tyre sipas ligjit, në koordinim me SHSHP-në.

#### **Neni 9** **Organet drejtuese**

1. Organet drejtuese të SHSHP-së sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për tregtarët dhe shoqëritë tregtare, të ndryshuar, janë:
  - a) Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit;
  - b) Këshilli Mbikëqyrës;
  - c) Administratori.
2. Kriteret dhe kërkesat për organizmin e brendshëm të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të shoqërisë miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

#### **Neni 10** **Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve**

1. Asambleja e Aksionerëve është organi vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja mbledhet të paktën një herë në vit dhe kur kërkohet nga Këshilli Mbikëqyrës ose nga Administratori.

#### **Neni 11** **Këshilli Mbikëqyrës**

1. Këshilli Mbikëqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë:
  - a) 2 (dy) anëtarë, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pyjet;
  - b) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për financat;
  - c) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për ekonominë;
  - ç) 1 (një) anëtar, përfaqësues nga ministria përgjegjëse për pushtetin vendor.
2. Këshilli garanton:
  - a) drejtimin strategjik;
  - b) mbikëqyrjen e performances së shoqërisë;
  - c) respektimin e objektivave publike.

## **Statusi juridik**

SHSHP sh.a. është person juridik me status tregtar, që ushtron veprimtari në përputhje me këtë ligj dhe legjislacionin në fuqi për shoqëritë tregtare.

### **Neni 4 Selia dhe njësitë operative**

1. Selia kryesore e SHSHP sh.a. është në Tiranë.
2. SHSHP mund të hapë degë dhe njësi operative rajonale në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas nevojave organizative dhe operacionale.
3. Vendosja e njësive operative rajonale bëhet me vendim të Administratorit, pas miratimit të Këshillit Mbikëqyrës, duke marrë parasysh shpërndarjen gjeografike të fondeve pyjore.

### **Neni 5 Qëllimi i veprimtarisë**

SHSHP ka për qëllim:

- a) administrimin e pasurisë pyjore shtetërore;
- b) zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm të fondeve pyjore shtetërore;
- c) mbrojtjen dhe rehabilitimin ekosistemeve pyjore;
- ç) rritjen dhe ruajtjen e vlerës së aseteve natyrore pyjore;
- d) kontributin në ekonominë kombëtare dhe zhvillimin rural;
- dh) zbatimin e politikave shtetërore dhe standardeve ndërkombëtare në menaxhimin pyjor.

### **Neni 6 Parimet**

Veprimtaria e SHSHP-së bazohet mbi parimet e menaxhimit të qëndrueshëm pyjor, si :

- a) ruajtja e produktivitetit biologjik dhe kapacitetit rigjenerues të pyjeve;
- b) mbrojtja e biodiversitetit, habitateve dhe specieve të rrezikuara;
- c) ruajtja e funksioneve hidrologjike, mbrojtëse dhe klimatike të pyjeve;
- ç) integrimi i kritereve sociale dhe ekonomike në vendimmarrjen mjedisore.

### **Neni 7 Fusha e veprimtarisë**

SHSHP sh.a. ushtron kompetencat dhe funksionet si më poshtë:

- a) menaxhimin dhe administrimin e pyjeve shtetërore;
- b) shfrytëzimin e kontrolluar të burimeve pyjore;
- c) menaxhimi i fidanishteve shtetërore;
- ç) pyllëzimin dhe ripyllëzimin;
- d) parandalimin dhe luftimin e zjarreve në pyje;
- dh) zhvillimin e aktiviteteve ekonomike të lidhura me pyjet, si:
  - i. tregtimi i lëndës drusore dhe produkteve jo-drusore;

**Neni 12**  
**Administratori**

1. Administratori është është organi ekzekutiv i shoqërisë.
2. Administratori përzgjidhet nga Këshilli Mbikëqyrës nëpërmjet një procedure të hapur, transparente dhe konkurruese,
3. Administratori ka përgjegjësi për:
  - a) menaxhimin operativ të shoqërisë;
  - b) realizimin e planit të biznesit dhe buxhetit vjetor, për miratim nga Këshilli Mbikëqyrës;
  - c) performancën financiare dhe teknike;
  - ç) raportimin periodik para Këshillit Mbikëqyrës.

**Neni 13**  
**Plani i menaxhimit dhe biznesit**

1. SHSHP sh.a harton:
  - a) plan menaxhimi afatgjatë të pyjeve;
  - b) plan biznesi vjetor dhe shumëvjeçar.
2. Planet miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe i paraqiten ministrisë për miratimin final.

**Neni 14**  
**Burimet Financiare**

1. SHSHP sh.a. ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me parimet e ekonomisë së tregut, duke ndjekur njëkohësisht realizimin e objektivave me interes publik.
2. Burimet financiare përfshijnë:
  - a) të ardhurat nga veprimtaria ekonomike ;
  - b) të ardhura nga buxheti i shtetit;
  - c) të ardhura nga grante si dhe financime ndërkombëtare ;
  - ç) të ardhura nga instrumenta të tjera financiare.
3. Shoqëria ka detyrimin për:
  - a) raportim financiar;
  - b) auditim të pavarur vjetor.
4. Viti financiar i shoqërisë përkon me vitin kalendarik.

**Neni 15**  
**Bashkëveprimi ndërinstitucional**

SHSHP sh.a. bashkëpunon me institucionet e mëposhtme sipas fushave të tyre të kompetencës:

- a) Ministrinë e Mjedisit;
- b) Agjencinë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura;
- c) Agjencinë Kombëtare të Mjedisit;
- ç) Njësitë e qeverisjes vendore;
- d) Institucionet akademike dhe kërkimore.

**Neni 16**  
**Kontrolli dhe raportimi**

1. SHSHP sh.a. i paraqet Ministrisë dhe Asamblesë së Përgjithshme, brenda datës 31 mars të çdo viti, raportin vjetor, i cili përfshin:
  - a) pasqyrat financiare të audituara;
  - b) raportin e performancës mbi treguesit ekonomikë, mjedisorë dhe socialë;
  - c) raportin e zbatimit të planit të biznesit dhe menaxhimit pyjor;
  - ç) raportin e auditimit të brendshëm dhe të jashtëm.
2. SHSHP sh.a raporton çdo 6 muaj pranë ministrisë përgjegjëse për pyjet mbi ecurinë operative dhe financiare.
3. Raporti vjetor i paraqitet Kuvendit të Shqipërisë nga ministria përgjegjëse për pyjet, brenda datës 31 maj, dhe bëhet publik.
4. Treguesit e performancës miratohen nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionerit dhe rishikohen çdo 2 vjet. Ata përfshijnë detyrimisht:
  - a) treguesit ekonomikë;
  - b) treguesit mjedisor;
  - c) treguesit socialë.

### **Neni 17** **E drejta e informimit**

1. SHSHP sh.a. mban dhe publikon në faqen e saj zyrtare:
  - a) raportet vjetore dhe financiare;
  - b) planet e menaxhimit pyjor dhe të biznesit;
  - c) vendimet e Asamblesë dhe Këshillit Mbikëqyrës me përjashtim të vendimeve konfidenciale;
  - ç) procedurat dhe rezultatet e prokurimeve publike;
  - d) të dhënat mbi gjendjen e fondeve pyjore.
2. Çdo person ka të drejtë të kërkojë informacion pranë SHSHP-së, sipas legjislacionit në fuqi për të drejtën e informimit.

### **Neni 18** **Aktet nënligjore**

1. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ministria përgjegjëse për pyjet, ndjek procedurat e nevojshme ligjore, për :
  - a) themelimin dhe miratimin e statutit të shoqërisë aksionare;
  - b) regjistrimin e Shoqërisë Shtetërore të Pyjeve sh.a., në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
2. Brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji:
  - a) Këshilli i Ministrave miraton kërkesat për organizmin e brendshëm të organeve drejtuese e të mënyrës së funksionimit të shoqërisë;
  - b) shpallet procedura e përzgjedhjes së Administratorit.
3. Brenda 6 (gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji:
  - a) kryhet inventarizimi i pasurisë pyjore;
  - b) miratohet plani i transferimit.
4. Brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve nga fillimi i veprimtarisë:
  - a) hartohet plani i parë i menaxhimit pyjor dhe plani i biznesit;

b) transferohen të gjitha asetet dhe personeli sipas protokollit të miratuar.

**Neni 19**  
**Dispozita kalimtare**

Strukturat ekzistuese të administrimit pyjor shtetëror vazhdojnë të funksionojnë deri në plotësimin e transferimit të plotë dhe nuk mund të marrin detyrime të reja afatgjata pa miratimin e Shoqërisë.

**Neni 20**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR**  
**SOFJAN JAUPAJ**